



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.03.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidaturën për anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, zonjën Xhoana Lilaj.

(Komisioni përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Xhoana Lilaj – kandidate për anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Sot kemi një seancë dëgjimore me kandidaten për anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, zonjën Xhoana Lilaj.

Propozimi vjen nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.48, datë 30.01.2019. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave vendosi t'i propozojë Kuvendit emërimin e zonjës Xhoana Lilaj si anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Zonja Lilaj është e pranishme në komision.

Ju falënderoj për ardhjen tuaj këtu!

Ju ftoj të bëni një prezantim të shkurtër. Më pas çdo anëtar komisioni është i lirë të bëjë pyetjet përkatëse.

Xhoana Lilaj - Kam mbaruar fakultetin juridik në Universitetin e Barit. Në 2009-n, mbasi kam mbaruar studimet, jam kthyer përfundimisht në Shqipëri dhe kam filluar aktivitetin tim profesional në administratën publike, në ish-Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (po bëj një prezantim të shkurtër të profesionit tim në administratë). Kam qenë në drejtorinë juridike për një periudhë 5-6 vjeçare. Më pas kam kandiduar dhe kam fituar pozicionin e drejtueses në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian, në Ministrinë e Integritetit Europian. Në 2016-n u angazhova në veprimtari të tjera jashtë administratës publike, si profesioniste në privat. Aktualisht, kam një kompani konsulence. Jam partnere dhe eksperte ligjore.

Kam përgatitur një fjalim të shkurtër për propozimin e kandidaturës sime, si anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Gjatë këtyre viteve tregu i telekomunikacionit në Shqipëri ka pasur zhvillime dhe investime të rëndësishme, që sollën kapërcimin e hendekut të madh digjital.

Zhvillimet e konkurrencës dhe rregullimet e tregut kanë bërë të mundur që sot të kemi shërbime me çmime të përballueshme, mundësi të shumta zgjedhjeje për konsumatorin nëpërmjet operatorëve, por edhe shërbime me cilësi të mirë.

Përmes politikave të ndjekura, me privatizimin e kompanive shtetërore dhe liberalizimin e tregut, në tregun shqiptar të telekomunikacionit është bërë e mundur futja e investitorëve strategjikë, me prezencë të kompanive serioze globale në telekomunikacion.

Në këtë kontekst, mbetem e vetëdijshme për rëndësinë strategjike të zhvillimit të ekonomisë së vendit nëpërmjet nxitjes së kryerjes së investimeve në këtë sektor.

Harmonizimi i duhur i politikave, i nismave, por edhe i zhvillimeve e procedurave mjaft domethënëse, në funksion të përmirësimit, ofrimit të shërbimeve në fushën e telekomunikacionit, do të përmirësojnë akoma më shumë klimën e biznesit, por edhe do të garantojnë investime të qëndrueshme në interes të zhvillimit kombëtar.

Një rol thelbësor në drejtimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka edhe Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues i AKEP-it, siç e dimë, është organi më i lartë vendimmarrës.

Në cilësinë e anëtares së këtij këshilli drejtues do të ushtroj funksionet e mia, që burojnë nga ligji, rregulloret dhe funksionet e këshillit drejtues, në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike dhe postare”, si dhe në ligjin nr. 46/2015 “Për shërbimet postare”.

Do të përmbush të gjitha detyrimet, që vijnë nga politikat sektoriale dhe zhvillimet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, konkluzionet dhe rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në rezolutën vjetore në kuadër të raportimeve të punës së AKEP-it në Kuvend, programit vjetor të punës së AKEP-it, si dhe objektivat dhe angazhimet e marra në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Nëpërmjet parimeve të asnjansisë teknologjike AKEP-i promovon konkurrencën dhe zhvillimin e një infrastrukture eficiente në komunikimet elektronike dhe njëkohësisht garanton shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

AKEP-i e ushtron funksionin në përputhje me ligjin nr.9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore, Rregulloren në fuqi, si dhe politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike me marrëveshje ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në vijim të përmbushjes së përgjegjësive ligjore të lartpërmendura, më lejoni të theksoj se një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë sime, si kandidatë për anëtare e këshillit drejtues të e AKEP-it, do të jetë angazhimi im në drejtimin e përmbushjes me përgjegjësi të detyrimeve, që burojnë nga ligji dhe aktet rregullore; ndjekja dhe zbatimi me prioritet i dokumenteve të miratuara në dhjetor të 2018-s; strategjia dhe plani i veprimit të AKEP-it për 2019-n, si dhe monitorimi i zhvillimit të këtij sektori në nivel europian. Ndërkohë, do të kontribuoj për çdo nismë, amendim apo modifikim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, me qëllim përafrimin e legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Europian.

Sigurisht, obligimi im në pozicionin e anëtares eventuale të këshillit drejtues do të jetë siguri i kushteve të favorshme të tregut për investorët, si dhe ndihma për heqjen e barrierave të mbetura.

Gjithashtu, ju siguroj se mbrojtja dhe adresimi i problematikave dhe interesave të konsumatorëve do të jenë në qendër të veprimtarisë sime, si anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

Nxitja e konkurrencës dhe mbrojtja e interesave të qytetarëve, pashmangshmërisht do të vijojë të sjellë përfitime të prekshme, çmim më të ulët, më shumë mundësi zgjedhjeje, shërbime të reja, si dhe prezantim të teknologjive të fundit.

Sikurse shprehen edhe aktet nënligjore e ligjore në fuqi, për sa u përket funksioneve të Këshillit Drejtues të AKEP, veprimtaria ime si anëtare e këtij këshilli do të fokusohet tërësisht në garantimin e një funksioni sa më efektiv transparent të të drejtave, konform kuadrit ligjor, që rregullon veprimtarinë e tij si organ kolegjal i një institucioni të pavarur.

Duke e konsideruar sektorin e telekomunikacioneve si një ndër sektorët më strategjikë për ekonominë e vendit, si dhe propozimin për t'u bërë pjesë e një prej institucioneve kyçe në këtë fushë të rëndësishme, më lejoni të shpreh një falënderim të veçantë për besimin e shprehur të kryeministrit ndaj meje, si dhe t'ju falënderoj për këtë mundësi eventuale të angazhimit tim si anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it!

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Ka pyetje nga anëtarët e komisionit? Nuk ka pyetje.

E falënderojmë zonjën Xhoana Lilaj për prezantimin!

Komisioni do të bëjë verifikimin e dokumentacionit konform ligjit, CV-në dhe vendimin e Këshillit të Ministrave. Më pas do t'ia paraqesë Kuvendit për seancën e ditës së mërkurë, kur kjo pikë është në rendin e ditës.

Shërbimi më thotë se është verifikuar konformiteti ligjor i dokumentacionit të zonjës Xhoana Lilaj, pra i CV-së dhe kërkesave që ka ligji për t'u bërë anëtare e AKEP-it.

Para se të konkludojmë, zoti Baraj ka një pyetje.

Besnik Baraj – Ju përmendet që keni një aktivitet privat. A ka konflikt interesi me...?

Xhoana Lilaj – Si partnere ortakë e këtij aktiviteti privat, deri tani nuk kam konflikt interesi, sepse objekti i veprimtarisë së kompanisë që drejtoj dhe jam pjesë nuk lidhet me objektin e veprimtarisë si anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it. Gjithsesi, përveçse ortakë ose partnere jam edhe konsulente. Në momentin kur do të bëhet emërimi im si anëtare e këshillit drejtues, unë do të jap dorëheqjen si konsulente.

Niko Peleshi – Dakord.

Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje të tjera...

Siç e thashë, sipas verifikimit për plotësimin e kërkesave ligjore, rezulton se zonja Xhoana Lilaj, siç është propozuar edhe nga Këshilli i Ministrave, i plotëson kushtet. Ne do t'i paraqesim Kuvendit opinionin pozitiv të Komsionit të Veprimtarisë Prodhuese, për ta bërë gati për votim në seancën parlamentare të ditës së mërkurë.

Xhoana Lilaj – Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Suksese!

Nesër kemi një mbledhje tjetër. Ndërkohë, kemi përgatitur edhe programin e punës së komisionit për periudhën 11-22 mars.

Elona, është shpërndarë për të gjithë?

E keni përpara programin e punës.

Në zbatim të Rregullores, do të kërkoj miratimin e këtij kalendari, që më pas të vijojmë me mbledhjet.

Jeni dakord me kalendarin?

Miratohet kalendari i punës.

Do të vijojmë punën sipas kalendarit.

Nesër në orën 11:00 është seanca për raportin e ERE-s.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA